

1. Në analizë të një shkresë tjetër të tij, nr. 1209, datë 05.04.2021 drejtuar Gjykatës Kushtetuese rezulton se Presidenti ka ndërhyrë në pavarësinë e një organi të pavarur duke udhëzuar se si duhet të vepronin gjyqtarët në vendimmarrje. Konkretisht shprehjet e Presidentit në këtë shkresë:

“...fatkeqësisht, Gjykata Kushtetuese, nuk arriti të vlerësojë objektivisht kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në raport me kontekstin aktual të vendit, përputhshmërinë e nenit 50 të Ligjit nr. 68/2017 me Kushtetutën, parimet e saj, duke lënë shteg të hapur për abuzim me interesin publik dhe justifikimin e kapjes së shtetit. Pesë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese u kujtoj përmbajtjen e nenit 162, pika 1 dhe 163 të Kushtetutës.... Këtyre dispozitave të Kushtetutës sonë, duhej t’i referohej shumica në Gjykatën Kushtetuese, për të marrë vendim të drejtë, gjë që nuk ka mundur ta bëjë. Nga ana tjetër, gjej rastin të falënderoj dy anëtarët e tjerë të kësaj gjykate, të cilat dhe pse të gjendura në pakicë, edhe në këtë vendimmarrje, si në shumë të tjera, kanë reflektuar përgjegjshmëri, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi duke shprehur qëndrimin e tyre kundër vendimit të shumicës...”

2. Ajo që vihet re që në fillim është që Presidenti i Republikës, në këtë rast së pari, nuk i drejtohet Gjykatës Kushtetuese si institucion, por i drejtohet në mënyrë individuale gjyqtarëve të këtij institucioni. Pra, në këtë rast kemi dukshëm një intimidim ndaj veprimtarisë së vetë gjyqtarëve.

3. Së dyti, Presidenti në këtë shkresë vlerëson anën profesionale të pesë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët sipas tij nuk ishin të aftë dhe nuk kuptonin siç duhet normat kushtetuese, të cilat merr përsipër që t’i sqarojë ai vetë. Kjo del qartë nga vetë shkresa e Presidentit, ku mbahet qëndrimi se:

Presidenti i Republikës, përmes këtij qëndrimi, shpreh shqetësimin e thellë për këtë çështje, e cila edhe pse kishte 3-vite që priste të shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese, kjo e fundit nuk i dha një zgjidhje të drejtë dhe kushtetuese, mbrojtjes së interesit publik, dhe as nevojës ekstreme që ka vendi sot për ruajtjen e pacenuar të financave publike.

...

Fatkeqësisht, Gjykata Kushtetuese, nuk arriti të vlerësojë objektivisht kërkesën e KLSH-së, në raport me kontekstin aktual të vendit, përputhshmërinë e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, me Kushtetutën dhe parimet e mbrojtura prej saj, duke lënë një shteg hapur për abuzim me interesin publik dhe justifikimin e kapjes së shtetit.

Pesë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që me votat e tyre rrëzuan kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kujtoj përmbajtjen e nenit 162 pika 1, dhe 163 të Kushtetutës.

...

Këtyre dy dispozitave të Kushtetutës sonë, duhej t`u referohej shumica në Gjykatën Kushtetuese, për të marrë një vendim të drejtë, gjë të cilën nuk ka mundur ta bëjë.

Pra, për Presidentin e Republikës, pesë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, nuk ditën t`i japin zgjidhje të drejtë dhe objektive çështjes, kanë lënë shteg për abuzime, nuk dinë të lexojnë Kushtetutën (përmbajtjen e neneve jua tregon Presidenti), si edhe si duhej që të vepronin për të marrë një vendim të drejtë.

4. Së treti, Presidenti merr përsipër të bëjë një diferencim midis vetë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kur bën vlerësimin edhe për dy gjyqtarë të tjerë të këtij institucioni. Kështu, në shkresën e tij, Presidenti shprehet se:

Nga ana tjetër, gjej rastin të falënderoj dy anëtarët e tjera të kësaj gjykate, të cilat edhe pse të gjendura në pakicë, edhe në këtë vendimmarrje, si në shumë të tjera, kanë reflektuar përgjegjshmëri, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi duke shprehur qëndrimin e tyre kundër vendimit të shumicës.

Ky diferencim midis gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese sjell si pasojë cenimin e figurës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, përderisa disa gjyqtarë konsiderohen se reflektojnë *përgjegjshmëri, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi*, duke nënkuptuar që këto cilësi nuk ekzistojnë tek pesë gjyqtarët e tjerë. Për më tepër, ky paragraf tregon se sulmi i Presidentit mbi Gjykatën Kushtetuese dhe dallimi midis gjyqtarëve nuk është vetëm për këtë vendimmarrje por edhe për raste të tjera. Kjo duket qartë nga përdorimi i shprehjes *si në shumë të tjera*.